

UDHËRRËFYES PËR IPA III

Mësimet, rritë dhe hapat e ardhshëm për 2021-2027

UDHËRRËFYES PËR IPA III

Mësimet, risitë dhe hapat e ardhshëm për 2021-2027

Titulli i publikimit:

UDHËRRËFYES PËR IPA III: Mësimet, risitë dhe hapat e ardhshëm për 2021-2027

Publikuar nga:

Instituti i Kosovës për Politikat Evropiane

Vendi dhe koha e publikimit:

Prishtinë, shkurt 2020



Ky raport është hartuar me mbështetjen e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur, KFOS. Përmbajtja e tij është përgjegjësia e vetme e Institutit të Kosovës për Politikat Evropiane dhe në asnjë formë nuk pasqyron pikëpamjet e Fondacionit për Shoqëri të Hapur, apo KFOS-it.

(faqe qëllimisht lënë zbrazët)

PËRMBAJTJA

Shkurtesat	6
Hyrja	8
Përmbledhje ekzekutive	10
Korniza Shumëvjeçare Financiare 2021-2027	13
Risitë në IPA III	20
Mësimet nga IPA II	28
Udhërrefyesi për IPA III	40
Prioritetet kyçe për IPA III	46
Rekomandimet	48
Lista e figurave	51
Referencat	52
SHTOJCA: Zërat e IPA-së	53

SHKURTESAT

AER	Agjenda Evropiane e Reformave
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BHV	Bruto të Hyrat Vendore
BNK	Bashkëpunimi Ndër Kufitar
BPV	Bruto Produkti Vendor
COREPER	Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm
COSME	Programi për Konkurruesmerinë e NVM-ve
COWEB	Grupi Punues për Ballkanin Perëndimor
DAZH	Departamenti i Asistencës Zhvillimore
DESI	Indeksi i Ekonomisë dhe Shoqërisë Digjitale
DG NEAR	Drejtorati i Përgjithshëm për Fqinjësi dhe Negociatat e Zgjerimit
DIEKP	Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave
DP	Dokumentet e Programimit
DPS	Dokumente Planifikuese Sektoriale
EaSI	Programi për Punësim dhe Inovacion Social
EJL	Evropa Jug Lindore
ERP	Programi për Reforma Ekonomike
ETC	Bashkëpunimi Territorial Evropian
FNL	Forumi Nivelit të Lartë
FP 7	Programi Kornizë për Hulumtim dhe Zhvillim Teknologjik
FWA	Marrëveshja Kornizë
GAC	Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme
GNP	Grupe Nën-sektoriale të Punës
GSP	Grupe Sektoriale të Punës
IPA I	Instrument i Para-Anëtarësimit 2007-2013
IPA II	Instrument i Para-Anëtarësimit 2014-2020
IPA III	Instrument i Para-Anëtarësimit 2021-2027
ISP	Instrumenti për Stabilitet dhe Paqe
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KB	Kombet e Bashkuara
KE	Komisioni Evropian
KFOS	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
KKI	Komiteti Kombëtar i Investimeve
KNIE	Komiteti Ndër-institucional për Integrim Evropian

M&R	Monitorimi dhe Raportimi
MAP	Plani Shumëvjeçar për Hapësirën Ekonomike Rajonale
MFF	Korniza Shumëvjeçare Financiare
MIE	Ministria e Integritimit Evropian
MSA	Marrëveshja Stabilizim Asocimi
NIPAC	Koordinatori Kombëtar i IPA-së
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
ONP	Organizata Ndërkombëtare e Punës
PE	Parlamenti Evropian
PKZMSA	Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së
PMNH	Platforma për Menaxhimin e Ndihmës së Huaj
PSA	Procesi Stabilizim Asocimi
QeQ	Qendra e Qeverisjes
SDG	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
SI	Strategjia Indikative për IPA
SIGMA	Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit
SPIS	Sistemi i Planifikimit të Integruar Strategjik
ShA	Shteti Anëtar
TBE	Traktati i BE-së
TFBE	Traktati mbi Funkcionimin e BE-së
WBIF	Korniza Investuese për Ballkanin Perëndimor
YCS	Skema e Profesionistëve të Rinj

HYRJA

Nese udhëtoni mbrapa në kohë në vitin 2007, kur u lansua Instrumenti i Asistencës Para-Anëtarësimit (IPA), do ta gjeni Kosovën nën administrimin e Kombeve të Bashkuara (KB). Ndihma e ofruar nën IPA synonte, ndër të tjera, të mbështesë "zgjdhjen e statusit" dhe "tranzicionin drejt një shoqërie të multi-etnike".

Sot kur reflektojmë për kohën që lam mbrapa nesh, mund konkludojmë që Kosova ka bërë një progres të konsiderueshëm. Sot, Kosova është një vend i pavarur, me institucione të zgjedhura në mënyrë demokratike, ekonomi të lirë të tregut dhe shoqëri multi-etnike. Anëtarësimi në BE është prioritet strategjik i Kosovës. Në këtë kontekst, mbështetja financiare e Bashkimit Evropian (BE) përmes IPA-së ka luajtur një rol kyç në avancimin e Kosovës.

Sidoqoftë, në fillimin e dekadës së re, Kosova përballet me sfida të reja. Kosova nuk njihet nga pesë vende të BE-së. Kjo e ka vendosur Kosovën në një situatë sui generis. Kosova ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) me BE-në, por ajo nuk arriti të ofroj zotimin e qartë për anëtarësim eventual në BE.

Përkundër kësaj, BE vazhdon të mbështesë perspektivën Evropiane të Kosovës. Që nga viti 1999, BE ka mbështetur Kosovën me afro 3 miliardë euro. Në kuadër të instrumentit të ri financiar IPA III për 2021-2027, BE do të vazhdojë të mbështesë agjendën Evropiane të Kosovës.

Në këtë kontekst, korniza e re shumëvjeçare financiare e BE-së do të ketë një rëndësi të veçantë. Shtatë vitet e ardhshme duhet të sjellin qartësi politike në aspiratën e anëtarësimit të Kosovës në BE. IPA III do të luajë rol kyç në mbështetjen e përpjekjeve të Kosovës gjatë periudhës 2021-2027.

Prandaj, në këtë kontekst, qëllimi i këtij studimi është që të reflektoj për mësimet nga IPA II dhe të shërbej si udhërrëfyes për hapat e ardhshëm për IPA III.

Studimi ka gjashtë kapituj dhe një shtojcë. Në kapitullin I, do të fillojmë me shpjegimin e elementeve kryesore të buxhetit të ardhshëm shtatë vjeçar të BE-së, apo Kornizen Shumëvjeçare Financiare (MFF). MFF është buxheti i BE-së dhe përfaqëson vizionin e BE-së për një periudhë shtatë vjeçare. Pas këtij diskutimi më të gjërë, në kapitullin

II do të fokusohemi në IPA III dhe risitë kryesore që IPA III do të sjell. Kapitulli III do reflektoj mbi mësimet nga IPA II dhe rrjedhimisht do na lejoj të kalojmë në kapitullin IV ku do prezantojmë udhërrëfyesin për IPA III. Në kapitullin V do të kalojmë në diskutime më thelbësore duke prezantuar prioritetet për financim për 2021-2027. Kapitulli VI do të prezantoj në formë të përmbledhur rekomandimet. Ndërsa, në fund të këtij studimi do të gjeni rezultatet e pyetësorit “Zërat e IPA-së” përmes të cilit jemi përpjekur të prezantojmë përvojën dhe mendimet e kolegëve nga institucionet, KE, komuniteti i donatorëve dhe shoqëria civile të cilët kanë pasur përvojë me IPA.

Në fund, dëshirojmë të falënderojmë institucionet e Kosovës, Komisionin Evropian (KE), komunitetin e donatorëve dhe shoqërinë civile për kontributin e tyre në kuadër të përgatitjes së këtij studimi. Shumica e asaj që do të gjeni këtu është bërë e mundur me mbështetjen tuaj bujare. Dhe sigurisht dëshirojmë të falënderojmë Fondacionin e Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) i cili e njohu rëndësinë e këtij projekti dhe pa mbështetje të të cilit e gjithë kjo nuk do të ishte e mundur.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Me 2 maj 2018, Komisioni Evropian propozoi MFF 2021-2027. Propozimi përbën një buxhet modern, afatgjatë dhe gjithëpërfshirës, në shërbim të axhendës progresive të dakorduar nga liderët në Romë dhe Sibiu. MFF është instrument kyç për të mbështetur Axhendën Strategjike të Këshillit Evropian dhe Udhëzimet Politike të Presidentes së Komisionit, znj. Ursula von der Leyen, mbi bazën e së cilës Parlamenti Evropian e zgjodhi atë.

Ndërsa ky studim u dërgua për shtyp, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme (GAC) vazhdon të debatojë për MFF 2021-2027. Presidenti i Këshillit Evropian do të zhvillojë diskutimet me qëllim të arritjes së një marrëveshje përfundimtare gjatë vitit 2020.

Paralelisht, Komisioni ka bërë progres drejt detajizimit të MFF-së së ardhshme me propozimet ligjore për 37 programet që do të zbatojnë prioritetet politike të BE-së. Rregullorja për themelimin e IPA III është njëra prej propozimeve.

Ndërsa institucionet e BE-së po ecin me shpejtësi të plotë përpara në përgatitjet e tyre për kornizën financiare 2021-2027, Kosova duhet të bëjë të njëjtën gjë. Është koha që Kosova të fillojë përgatitjet për IPA III. Kjo do të sigurojë që Kosova mund të angazhohet në dialog holistik dhe empirik me Komisionin për përdorimin e IPA III.

Në këtë kontekst, studimi ynë duhet të shërbejë si kontribut për të gjithë palët e interesuara në diskutimet e tyre për IPA III.

Hulumtimi ynë na ka sjell në dymbëdhjetë konkluzione:

- MFF 2021-2027 do të ketë një **buxhet prej 1,279 miliardë EURO** (çmimet aktuale) - që përfaqëson 1.11% të Bruto të Hyrave Vendore (BHV) të BE27. Kjo është 1% e BHV kombinuar e shteteve anëtare të BE-së;
- MFF 2021-2027 karakterizohet me **5 elemente kyçe**: (1) më shumë fonde për fushat prioritare; (2) menaxhimi i mirë financiar dhe sundimi i ligjit; (3) vlera e shtuar Evropiane; (4) më pak burokraci; (5) një buxhet i thjeshtuar dhe më fleksibël;
- Në IPA III, **Komisioni propozoi rritjen e fondeve** nga 12.1 miliardë EURO në 14.5 miliardë EURO - një rritje prej 13%;

- IPA III do të ketë **pesë objektiva kryesore**: (1) sundimi i ligjit, demokracia dhe të drejtat themelore; (2) qeverisje e mirë; (3) politikat e Unionit dhe acquis; (4) zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia sociale; dhe (5) bashkëpunim territorial dhe ndërkuftar;
- Progresi do të matet përmes **dhjetë treguesve të performancës**;
- Risitë e IPA III frymëzohen nga parimi **'më shumë për më shumë'**. Supozimi themelor është se asistenca më e madhe financiare, do të prodhojë rezultate më të prekshme. Në këtë drejtim, risitë e IPA III mund të përmbliidhen përgjatë katër parimeve: (1) më strategjik; (2) më i fokusuar; (3) më shumë investime; dhe (4) më shumë ndikim;
- Me gjasë, **risia më e rëndësishme** e IPA III është që ndarjet financiare nuk do të bëhen më mbi bazën e alokimeve kombëtare, por mbi parimin e performancës;
- Duke njohur rëndësinë e **Agjendes së Gjelbër Evropiane** është e rëndësishme të nëvizohet qëllimi i Komisionit për të alokuar 16% të buxhetit të IPA III për qëllime të ndryshimeve klimatike;
- Sa i përket IPA II, kemi nxjerr **shtatë mësim**: (1) IPA II është shumë relevante, në harmoni me prioritetet kombëtare dhe BE-së, si dhe asistencën e donatorëve; (2) IPA II është e orientuar drejt ndryshimit; (3) Ekziston mungesa e pronësisë dhe sindromit të "botës paralele"; (4) Korniza e planifikimit kombëtar është e brishtë; (5) Mungesa e vendimmarrjes empirike dhe proceseve të strukturuar; (6) Nuk ka 'kthyeshmëri automatike' të fondeve IPA; (7) Defektet e asistencës teknike;
- Ne kemi paraqitur **dhjetë parime** të cilat do të duhej të janë bazë e përgatitjeve të Kosovës për IPA III. Për më tepër, ne kemi propozuar një **udhërrëfyes me dhjetë hapa** specifike që duhet të ndiqen nga institucionet e Kosovës;
- Ne kemi propozuar **trembëdhjetë prioritetet**, të grupuara në katër fusha kryesore: (1) sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore; (2) demokracia dhe qeverisja; (3) rritja ekonomike; (4) Agjenda e Gjelbër e Kosovës;
- Në fund, pyetësi **"zërat e IPA-së"** na ka ofruar disa të dhëna interesante. Ekziston një konsensus në mesin e të anketuarve se IPA është **shumë relevante**, dhe në përputhje me prioritetet kombëtare dhe të BE-së, si dhe asistencën e donatorëve. Sa i përket **koherencës dhe sinergjisë**, përderisa ekziston një konsensus se IPA është e fokusuar, shumica e të anketuarve konsiderojnë se procesi i konsultimit të IPA-së është i papërshtatshëm. Sa i përket **efektivitetit**, të anketuarit kanë mendime kontradiktore për pothuajse të gjitha aspektet e efektivitetit të IPA-së. Në lidhje me **efikasitetin**, shumica e të anketuarve konsiderojnë se IPA nuk është efikase duke marr parasysh koston e zbatimit të saj. Sa i përket **pronësisë**, shumica e të anketuarve konsiderojnë se institucionet nuk drejtojnë procese të lidhura me IPA, por përkundrazi pronësia qëndron në duart e KE-së. Për më tepër, ata konsiderojnë se donatorët dhe shoqëria civile

nuk janë të përfshirë në mënyrë sistematike në proceset e lidhura me IPA. Lidhur me **fleksibilitetin**, shumica e të anketuarve konsiderojnë se IPA është administrativisht shumë e komplikuar dhe jo fleksibile. Të anketuarit kanë mendime kontradiktore për pothuajse të gjitha aspektet e proceseve të **programimit dhe monitorimit** IPA. Sa i përket prioriteteve për IPA III, të anketuarit e konsiderojnë arsimin, mjedisin, konkurrueshmërinë ekonomike, sundimin e ligjit dhe shëndetin si pesë prioritetet më të rëndësishme.

Në fund, duhet cekur se të dhënat financiare të paraqitura në këtë studim bazohen në propozimin e MFF-së të Komisionit Evropian të bërë në maj 2018. Duke njohur negociatat e vazhdueshme të MFF-së brenda institucioneve të BE-së, këto të dhëna mund të ndryshojnë.

I. KORNIZA SHUMËVJEÇARE FINANCIARE 2021-2027

Neni 312 i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian ("Traktati") është baza ligjore e MFF-së. MFF themelohet përmes Rregullores e cila miratohet njëzëri nga ana e Këshillit të BE-së. Këshilli bënë miratimin në përputhje me procedurën e veçantë legjislative, pasi të marrë pëlqimin e Parlamentit Evropian.

MFF është buxheti afatgjatë i BE-së. Ai përcakton kufijtë e shpenzimeve të BE-së – në tërësi dhe për fusha të ndryshme të shpenzimeve - për një periudhë të paktën pesë vjeçare. MFF-të mbulojnë periudhën shtatë vjeçare. Qëllimi i MFF-së është: (1) të harmonizojë shpenzimet e BE-së me prioritetet politike; (2) të sigurojë disiplinën buxhetore të BE-së; (3) ta lehtësojë miratimin e buxhetit vjetor të BE-së; dhe (4) të sigurojë parashikueshmërinë e financave të BE-së.

Çysh nga politika e parë madhore e BE-së - bujqësia - në vitet 1960 e deri më sot, buxheti i BE-së ka ndryshuar në mënyrë progresive dhe paralelisht me ndërtimin e BE-së.

Në vitet 1980 dhe 1990, Shtetet Anëtare dhe Parlamenti Evropian zgjeruan kompetencat e BE-së përmes ndryshimeve në traktatet themeluese të BE-së. Duke njohur nevojën për të mbështetur tregun e ri unik, ata rritën buxhetin e fondeve strukturore për të mbështetur kohezionin ekonomik, shoqëror dhe territorial. Paralelisht, BE-ja e rriti rolin e saj në fushat sikur transporti, hapësira, shëndetësia, arsimit dhe kultura, mbrojtja e konsumatorit, mjedisi, hulumtimi, bashkëpunimi në drejtësi dhe politika e jashtme.

Që nga viti 2000, buxheti i BE-së është ndikuar kryesisht nga ardhja e 13 shteteve të reja anëtare me situata të ndryshme socio-ekonomike dhe nga qasja e vazhdueshme e BE-së për tu fokusuar në krijimin e vendeve të punës. Po ashtu, buxheti është vënë në dispozicion mbështetjes së BE-së në rolin e saj udhëheqës në botë, si lider në luftimin e ndryshimeve klimatike dhe donatori më i madhë në botë[1].

Më 2 maj 2018, Komisioni paraqiti propozimet e tij për një buxhet modern afatgjatë për periudhën 2021-2027. Këto propozime janë ndërtuar mbi prioritetet politike të

[1] Reflektimet për të ardhmen e financave të BE-së, KE, qershor 2017

të dakorduara nga liderët në Bratisllavë dhe Deklaratën e Romës. Parimi udhëheqës ishte 'vlera e shtuar Evropiane'.

Propozimi përmban këto 5 karakteristika kryesore[2]:

1. **Më shumë fonde për fushat prioritare:** për herë të parë ndonjëherë, buxheti i alokuar për prioritetet e reja është më i lartë se buxheti për politikën bujqësore apo politikën e kohezionit. Kjo është në harmoni me prioritetet politike dhe atë çfarë kanë kërkuar qytetarët e BE-së;
2. **Menaxhimi i mirë financiar dhe sundimi i ligjit:** Komisioni ka fuqizuar rregullat financiare duke krijuar mekanizmin e cili mbron buxhetin e BE-së nga defektet në sundimin e ligjit brenda shteteve të caktuara anëtare. Mekanizmi i ri buxhetor për kontroll do jetë objektiv, transparent do të aplikohet për të gjitha vende anëtare;
3. **Vlera e shtuar Evropiane:** për herë të parë, një e treta e buxhetit do të dedikohet fushave prioritare ku buxheti i BE-së mund të arrij rezultatet më të mira se intervenimi nacional;
4. **Më pak burokraci:** MFF i ri do thjeshtësoj rregullat për financimin nga buxheti i BE-së, duke zvogëluar burokracinë dhe duke e bërë më të lehtë aplikimin për fonde të BE-së. Komisioni do propozoj thjeshtësimin e rregullave të ndihmës shtetërore në mënyre që financimi nacional dhe Evropian të janë më komplementar;
5. **Më shumë fleksibilitet dhe thjeshtësi:** zvogëlim i programeve nga 58 në 37. Programet e reja do krijohen në fusha kyçe strategjike, siç janë punët e jashtme dhe tregu unik. Fondi i ri InvestEU do bashkoj të gjithë instrumentet financiare për të përkrahur investimin në BE, duke ndërtuar mbi suksesin e Fondit Evropian për Investimet Strategjike.

[2] Buxhet modern për Unionin i cili Ruan, Fuqizon dhe Mbron, KE, maj 2018.


Figura 1: Karakteristika kyçe të buxhetit të ardhshëm të BE-së[3]



Propozimi përmban buxhetin prej €1,279 miliard (çmimet aktuale) – që përfaqëson 1.11% të Bruto të Hyrave Vendore (BHV) të BE27.

Buxheti i BE-së është relativisht i vogël pasi që përfaqëson 1% të BHV-së të Shteteve Anëtare, dhe vetëm 2% të shpenzimeve publike të BE-së. Për çdo 100 EURO që qytetarët e BE-së fitojnë, ata paguajnë mesatarisht 50 EURO për tatime dhe kontribute, ndërsa vetëm 1 EURO shkon për buxhetin e BE-së[4].

Figura 2: Buxheti i BE-së krahasuar me të hyrat e BE-së dhe shpenzimet publike[5]



Për më pak se çmimi i një kafeje në ditë, qytetarët e BE-së financojnë buxhetin i cili menaxhon çështjet të cilat tejkalojnë kufijtë shtetëror dhe cilat kërkojnë veprim Evropian dhe ndërkombëtar. Nga ndryshimet klimatike dhe energjia, deri te migrimi, mbrojtja e konsumatorit, globalizimi, punësimi, tregu unik dhe monedha e përbashkët, buxheti kontribuon në prosperitetin e qytetarëve të BE-së dhe suksesin e politikave të përbashkëta. Përvoja ka dëshmuar që edhe buxheti modest i BE-së në nivelin Evropian mund këtë ndikim madhor në jetë e qytetarëve.[6]


[3] Ibid.

[4] Reflektimet për të ardhmen e financave të BE-së, KE, qershor 2017

[5] Ibid.

[6] Ibid.


Figura 3: Madhësia e buxhetit të BE-së si përqindje e BHV-së[7]



Moto i MFF të ri është: Buxhet modern, i orientuar kah rezultatet për të ardhme më të mirë. Kjo kërkon rishikimin e shpenzimeve në mes fushave prioritare me qëllim të maksimizimit të efektiviteti të tyre[8].

Në propozimin e tij për buxhetin e ardhshëm afatgjatë të BE-së, Komisioni ka sugjeruar që për herë të parë alokimi financiar për prioritete të reja të jetë më i lartë se buxheti për politiken bujqësore apo politikë e kohezionit.[9]

Figura 4: Evoluimi i fushave prioritare brenda buxhetit të BE-së[10]



[7] Buxhet modern për Unionin i cili Ruan, Fuqizon dhe Mbron, KE, maj 2018.

[8] Kontributi i Komisionit Evropian për takimin e Këshillit Evropian me 17-18 tetor 2019, KE, tetor 2019.

[9] Buxheti modern për sfidat e reja, KE, tetor 2019.

[10] Kontributi i Komisionit Evropian për takimin e Këshillit Evropian me 17-18 tetor 2019, KE, tetor 2019..

Në propozimin e tij Komisioni është siguruar se BE-ja ka resurset e nevojshme për të vepruar në fushat prioritare, siç janë: ndryshimet klimatike, migrimi dhe punët e jashtme, si dhe ka siguruar që të këtë mbështetje për reformat strukturore në shtetet anëtare[11].

Në veçanti, përmes MFF-së së re, Komisioni synon përmbushjen e katër objektivave kyçe[12]:

1. **Qasje ambicioze për ndryshimet klimatike:** cak prej së paku 25% të shpenzimeve që do kontribuojnë drejt objektivave klimatike është ambicioz dhe mund të arrihet përmes caqeve sektoriale;
2. **Përgjigje holistike sfidave të migrimit;**
3. **Ofrimin e mbështetjes drejt reformave nacionale dhe prioriteteve investive;**
4. **Mbështetje zbatimit të Shtyllës Evropiane për të Drejtat Sociale,** përmes Fondit Social Evropian Plus, me fokus në investimet në njerëz dhe kohezionin social.

Përmes MFF-së së re, programet do janë të organizuara mbi bazën e fushave prioritare të shpenzimeve. Brenda secilit prioritet, programet do janë të organizuara në grupet e politikave, të cilat do të reflektojnë titujt e buxhetit vjetor. Arkitektura e re do ofroj transparencën më të madhe se për çfarë qëndron buxheti i BE-së. Po ashtu, do ofroj fleksibilitet më të madh për tu përgjigjur nevojave të vazhdueshme dhe emergjencave të paparashikueshme në fushën e sigurisë dhe migrimit.[13]


[11] Buxheti modern për sfidat e reja, KE, tetor 2019.

[12] Ibid.

[13] Buxhet modern për Unionin i cili Ruan, Fuqizon dhe Mbron, KE, maj 2018.

[14] Ibid.

Figura 5: Struktura e MFF-së 2021-2027 (në miliard euro, çmimet aktuale)[14]



Nëse BE-ja dëshiron të avancoj, ajo duhet të këtë buxhet i cili do jetë na harmoni me ambiciet e saja. Investimi në fushat siç është hulumtimi dhe inovacioni, të rinjtë dhe ekonomia digjitale do janë në shërbim gjeneratave të ardhshme. Kjo është arsyeja përse Komisioni propozon rritjen e shpenzimeve në këto fusha prioritare.[15]




Figura 6: Fushat me rritjen më të madhe të financimit[16]


Komisioni ka propozuar kornizë buxhetore e cila është më koherente, më e fokusuar dhe më transparente. Struktura e buxhetit do jetë më e qartë dhe më e përafuar me prioritetet e BE-së. Komisioni ka propozuar zvogëlimin e programeve nga 58 në 37.

[14] Ibid.

[15] Buxhet modern për Unionin i cili Ruan, Fuqizon dhe Mbron, KE, maj 2018.

[16] Ibid.

Figura 7: Zvogëlimi i numrit të instrumenteve me MFF 2021-2027



II. RISITË NË IPA III

Në kapitullin paraprak kemi shpjeguar elementet kyçe të MFF-së së re. Në këtë formë kemi shtruar rrugë për të filluar diskutimin më të fokusuar për IPA III.

Neni 49 i Traktatit të BE-së parasheh se çdo shtet Evropian i cili respekton vlerat e dinjiteti njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, sundimit të ligjit dhe respektimit të drejtave njeriut, përfshirë të drejtat e minoriteteve, mund të aplikoj për tu bërë anëtar i BE-së.

Asistenca e Para-Anëtarësimit mbështet shtetet kandidate dhe shtetet kandidate potenciale në adoptimin dhe zbatimin e reformave kyçe politike, institucionale, sociale dhe ekonomike me qëllim të përafrimit me vlerat Evropiane dhe anëtarësimit eventual në BE. Baza ligjore për Instrumentin e Asistencës së Para-Anëtarësimit është neni 212(2) të Traktatit për Funkcionimin e BE-së.

Me 14 qershor 2018, Komisioni prezantoi propozimin për Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për themelimin e Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA III). Rregullorja do miratohet në përputhje me procedurën e zakonshme legjislativ, nga ana e Parlamentit dhe Këshillit. Parlamentet nacionale do informohen për aktin legjislativ, ndërsa opinionet e Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komitetit të Rajoneve do mirën parasysh.

Sipas MFF-së së re 2021-2027, respektivisht titulli VII, Fqinjësia dhe Bota, Komisioni propozon rritjen e fondeve të IPA-së nga 12.1 miliard EURO në 14.5 miliard EURO – rritje prej 13%.^[18]

FUNDING 2021-2027

 **13%**
increase
compared to
current funding

 **€14.5**
billion

[18] Instrumenti i ri i Asistencës së Para-Anëtarësimit, KE, qershor 2018.

Figura 8: Buxheti i IPA II vs IPA III
(draft propozimi i KE-se)





Figura 9: Buxheti IPA, sipas viteve
(draft propozimi i KE-se)



II.2. IPA III objektivat

Objektivi i përgjithshëm i IPA III është të mbështes vendet në adoptimin dhe zbatimin e reformave kyçe politike, institucionale, sociale dhe ekonomike me qëllim të përafrimit me vlerat Evropiane dhe anëtarësimit eventual në BE, duke kontribuar kështu në stabilitetin, sigurinë dhe prosperitetin e Unionit[19].

IPA III do këtë këto pesë objektiva specifike[20]:

1. Fuqizimi i **sundimit të ligjit, demokracisë, respektimit të drejtave njerëzore dhe të drejtave themelore**, shoqëria civile, siguria, si dhe përmirësimi i menaxhimit të migrimit;
2. Përmirësimi i efektivitetit të administratës publike dhe mbështetja reformave strukturore dhe **qeverisjes së mirë** në të gjitha nivelet;
3. Përafrimi i rregullave, standardeve, politikave dhe praktikave të vendeve me BE-në, si dhe **promovimi i pajtimit dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore**, përfshirë kontaktet në mes qytetarëve;
4. Promovimin e **zhvillimit ekonomik dhe social**, përfshirë përmes ndërlidhjes më të mirë infrastrukturore dhe zhvillimit rajonal, bujqësia dhe zhvillimi rural, politikat sociale dhe të punësimit, mbrojtja mjedisore, si dhe ekonomia digjitale;
5. Mbështetja **bashkëpunimit territorial dhe ndërkufitar**.

[19] Propozimi për Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për themelimin e Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimin (IPA III), KE, qershor 2018.

[20] Ibid.

Figura 10: Objektivat e IPA-së III (draft propozimi i KE-se)

PESË OBJEKTIVA TË IPA-SË III

2021-2027

1

**SUNDIMI I LIGJIT,
DEMOKRACIA DHE TË
DREJTAT THEMELORE**

2

QEVERISJA E MIRË

3

**POLITIKAT E BE-SË DHE
ACQUIS**

4

**ZHVILLIMI SOCIAL DHE
EKONOMIK**

5

**BASHKËPUNIMI TERRITORIAL
DHE NDËRKUFITAR**

Në kuadër të IPA-së III, Komisioni ka propozuar dhjetë indikatorë specifik për monitorimin e zbatimit dhe progresit drejt pesë objektivave specifike[21]:

1. Indikator[22] për gatishmërinë e shteteve të zgjerimit në fushat themelore të kriterëve politike (përfshirë demokracinë, sundimin e ligjit (gjqësori, lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar) dhe të drejtat njeriut) (burim KE);
2. Gatishmëria e vendeve të zgjerimit në kuadër të reformës së administratës publike (burim KE);
3. Indikator për gatishmërinë e shteteve kandidate dhe kandidate potenciale për zbatimin e acquis së BE-së (burim KE);
4. Indikator për gatishmërinë e shteteve kandidate dhe kandidate potenciale në fushat themelore të kriterëve ekonomike (funksionimi i ekonomisë së tregut dhe konkurrueshmërisë) (burim KE);
5. Shpenzimet publike për sigurinë sociale (përqindja e BPV) (burim ONP) apo shkalla e punësimit (burim: statistikat nacionale);
6. Dallimi në rangimin digjital në mes shteteve të zgjerimit dhe BE-së (burim: Indeksi DESI i KE-së);
7. Distance to frontier (Të Bërit Biznes) rangimi (burim BB);
8. Intensiteti i energjisë i matur në kuptimin e energjisë primare dhe BPV (burim EUROSTAT);
9. Emitimet e gazrave serë të reduktuara apo shmangura (Ktons CO₂eq) me mbështetjen e BE-së;
10. Numri i programeve të bashkëpunimit ndërkuftar të konkluduara në mes shteteve të zgjerimit dhe shteteve anëtare të BE-së (burim KE).

[21] Ibid.

[22] Tre indikatorët do shpjegohen nga ana e Komisionit Evropian duke marr për bazë raportet e zgjerimit, të cilat po ashtu hartohen bazuar në burimet e shumta të pavarura.

Figura 11: Indikatorët e IPA III, sipas pesë objektivave specifike

DHJETË INDIKATORËT PËR IPA III

2021-2027

SUNDIMI I LIGJIT, DEMOKRACIA & TË DREJTAT THEMELORE

1. Gatishmëria në kuadër të kriterëve politike

QEVERISJA E MIRË

2. Gatishmëria në kuadër të reformes administrates publike

POLITIKAT E BE-SË DHE ACQUIS

3. Gatishmëria në kuadër të acquis së BE-së

ZHVILLIMI SOCIAL DHE EKONOMIK

- 4. Gatishmëria në kuadër të kriterëve ekonomike
- 5. Shpenzimet publike për sigurinë sociale (% BPV) apo shkalla e punësimit
- 6. Dallimi në rangimin digjital me mesataren e BE-së
- 7. Distance to frontier (Të Bërit Biznes) rangimi
- 8. Intensiteti i energjisë i matur në kuptimin e energjisë primare dhe BPV
- 9. Emitimet e gazrave serë të reduktuara apo shmangura (Ktons CO₂eq) me mbështetjen e BE-së

BASHKËPUNIMI TERRITORIAL DHE NDËRKUFITAR

10. Numri i programeve të bashkëpunimit ndërkufitar të konkluduara në mes shteteve të zgjerimit dhe shteteve anëtare të BE-së

II.3. Risitë e IPA III

Risitë e IPA III për 2021-2027 nuk janë një ndryshim rrënjësor i zbatimit të fondeve të BE-së, por paraqesin një evoluim të parimeve të cilët kanë demonstruar në mënyrë empirike që mbështesin progresin dhe ndryshimin në Ballkanin Perëndimor. Në këtë formë, IPA III bënë përpjekje për të mbështetur progres të prekshëm në kuadër të zgjerimit të BE-së, siç është nënvizuar edhe në kuadër të diskutimeve të fundit politike mbi zgjerimin brenda Këshillit Evropian.

Me gjasë, risia më e rëndësishme e IPA III është që ndarjet financiare nuk do të bëhen më mbi bazën e alokimeve kombëtare, por mbi parimin e performancës. Po ashtu, duke njohur rëndësinë e Agjendës së Gjelbër të BE-së është e rëndësishme të nënvizohet qëllimi i Komisionit për të alokuar 16% të buxhetit të IPA III për qëllime të ndryshimeve klimatike.

Përtej alokimeve financiare, risitë e IPA III janë të frymëzuara nga parimi 'më shumë për më shumë'. Supozimi themelor është se asistencë më e madhe financiare, do të prodhojë rezultate më të prekshme. Në këtë drejtim, risitë e IPA III mund të përmbliidhen përgjatë katër parimeve:

1. Më strategjik;
2. Më i fokusuar;
3. Më shumë investime; dhe
4. Më shumë ndikim.

Më strategjik: IPA III do zbatohet brenda një kornize shumë të rëndësishme kohore. Brenda shtatë viteve të ardhshme, shtetet e Ballkanit Perëndimor pritet të bëjnë progres në kuadër rrugëtimit të tyre respektiv drejt BE-së. Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut do hapin negociatat. Serbia dhe Mali i Zi do bëjnë progres të mëtutjeshëm në hapjen dhe mbylljen e kapitujve. Kosova dhe Bosnja do synojnë statusin e vendit kandidat. Në këtë kontekst, IPA do të luan rol kyç në mbështetjen e këtyre vendeve drejt aspiratave të tyre Evropiane. IPA III do të ndërtoj mbi sukseset e IPA II dhe do lëviz pronësinë për reforma edhe më tutje drejt shteteve të zgjerimit. Po ashtu, IPA III do të fuqizoj parimin e ndarjes së mjeteve financiare mbi meritat e performancës.

Më i fokusuar: Vendet e Ballkanit Perëndimor ballafaqohen me shumë prioritetet në rrugën e tyre Evropiane. Çdo gjë që mund të paramendojmë nga politikat mjedisore, lufta kundër korrupsionit e deri tek të drejtat e pronësisë intelektuale. Në këtë

drejtim, BE-ja në vazhdimësi ka vendosur vëmendjen në çështjet kyçe, duke insistuar se reformat më të rëndësishme vijnë të para dhe shërbejnë si shtyllë për reformat e më vonshme. Me kalimin e kohës kjo qasje është zyrtarizuar në kuadër të politikës “fundamentals first” – fokusi në sundim të ligjit, të drejtat themelore, qeverisja e mirë dhe konkurrueshmëria ekonomike. IPA III njihet rëndësinë e “fundamentals first” si element kyç për suksesin e saj gjatë 2021-2027.

Më shumë investime: Ballkani Perëndimor ka qenë dëshmitar i migrimit të lartë gjatë dekadës së fundit. 44% të popullatës së Shqipërisë dhe 30% popullatës së Kosovës kanë migruar drejt BE-së gjatë 2008-2018.[23] Shkaqet kryesore për tendencat aq të mëdha të migrimit janë ekonomike. Në Shqipëri, 73% e rinisë e shohin papunësinë së brengë kryesore.[24] Në Kosovë, 73.5% e rinisë kanë besim të kufizuar, ose nuk kanë besim fare, se do gjejnë vend pune në gjashtë muaj të ardhshëm.[25] Në këtë drejtim, IPA III do vendos theks të veçantë në sektorë strategjik, siç janë: agjenda digjitale, ndërlidhshmëria, inovacioni dhe eficientia e energjisë. Vendet e Ballkanit Perëndimorë do kanë qasje në Fondin Evropian për Zhvillim të Qëndrueshëm Plus (EFSD+) dhe Veprimin e Jashtëm Garantues. Këto instrumente të reja do ofrojnë financim shtesë prej €60 miliard, me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës, konkurrueshmërisë dhe krijimit të vendeve të punës.

Më shumë ndikim: Siç kemi shpjeguar në kapitullin I, në kuadër të MFF-së së re, arkitektura e veprimit të jashtëm do këtë një përmirësim të madh në koherencën e saj. Kjo do siguroj bashkimin e njëmbëdhjetë instrumenteve financiare të BE-së në një instrument të vetëm financiar: Instrumenti i Fqinjësisë dhe Bashkëpunimit Zhvillimor dhe Ndërkombëtar (NDICI). Arkitektura e instrumenteve të reja financiare do siguroj koherencë dhe sinergji në mes IPA III dhe NDICI. Kjo do aplikohet në veçanti në rastet e komponentëve tematike dhe ato për reagim të shpejtë, në raste ku objektivat e caktuara nuk mund të arrihen përmes programeve gjeografike. Po ashtu, IPA III do krijoj sinergji me programet e shumta të Unionit, siç janë siguria, migrimi, hulumtimi dhe inovacioni, mjedisi, ndërlidhshmëria dhe energjia.[26]

[23] Migrimi i Ballkanit Perëndimor drejt BE-së, Instituti i Kosovës për Politikën Evropiane, nëntor 2019.

[24] Të rinjë në Shqipëri 2019, Rrjeti Kombëtar i të Rinjve të Shqipërisë, nëntor 2019.

[25] Sfidat dhe perspektivat e Rinisë në Kosovë, UNDP Kosova, gusht 2018.


[26] Propozimi për Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për themelimin e Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimin (IPA III), KE, qershor 2018.

Figura 12: Risitë e IPA III (draft propozimi i KE-se)



Për të kuptuar drejt progresin gradual të IPA-së është e rëndësishme që risitë e IPA-së të vendosen në perspektivë dhe të krahasohen me paraardhësit e saj.

Figura 13: Evoluimi i elementeve kryesore të IPA-së çysh nga 2007



III. MËSIMET NGA IPA II

III.1 Konteksti

Kosova ka pranuar 650 milion EURO nga IPA I (2007-2013). Në IPA II (2014-2020), Kosova ka pasur në dispozicion një buxhet prej 602.10 milion EURO.

Asistenca e BE-së gjatë 2014-2020 ka kontribuar në reformat në kuadër sektorëve në vijim:

1. **Demokracia dhe qeverisja.** Në veçanti: institucionet demokratike dhe të pavarura, reforma e administratës publike, qeverisja ekonomike, statistikat dhe shoqëria civile;
2. **Sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore.** Në veçanti: drejtësi, çështje të brendshme, të drejtat themelore dhe minoritetet;
3. **Mjedisi, ndryshimet klimatike dhe energjia;**
4. **Konkurruesmeria, inovacioni, bujqësia dhe zhvillimi rural**
5. **Arsimi, punësimi dhe politikat sociale;**
6. **Bashkëpunimi rajonal dhe territorial.** Në veçanti: Korniza Investuese për Ballkanin Perendimor (WBIF), Rrjeti Rajonal për Mjedis (ECRAN), Bashkëpunimi Territorial Evropian (ETC) dhe bashkëpunimi ndërkufitar (BNK).




Figura 14: Alokimet financiare në miliona EURO

Në kuadër të kapitullit të ardhshëm do të ofrojmë disa rlefktime për IPA II dhe do të nxjerrim disa mësimë nga periudha që po lojm prapa nesh.

III.2 Mësimet nga IPA II

Hulumtimi ynë na ka sjell tek shtatë mësimet nga IPA II:

1. IPA II është shumë relevante;
2. IPA II është e orientuar drejt ndryshimit;
3. Ekziston mungesa e pronësisë dhe sindromit të "botës paralele";
4. Kornizë e planifikimit kombëtar është e brishtë;
5. Mungesa e vendimmarrjes empirike dhe proceseve të strukturuar;
6. Mungesa e 'kthyeshmërisë automatike' të fondeve IPA;
7. Defektet e asistencës teknike. IPA II is highly relevant.

IPA II ËSHTË SHUMË RELEVANTE. Me qëllim të vlerësimit të relevancës së IPA II në këtë pjesë të studimit kemi ekzaminuar harmoninë e prioriteteve të IPA-së me prioritetet kyçe nacionale, respektivisht:

- Prioritetet politike që burojnë nga procesi i integritimit Evropian, siç janë të përkufizuara në 'fundamentals first';
- Strategjia Kombëtare e Zhvillimit;
- Programi për Reforma Ekonomike.

Në këtë drejtim, mund konkludojmë se ka një harmoni të madhe të prioriteteve në mes IPA II dhe dokumenteve të lartëcekura nacionale. Natyrisht, egzistojnë disa mospërputhje, por këto janë në masë të madhe për shkak se disa dokumente kanë një fushëveprimtari më të kufizuar, ku për shembull të drejtat themelore apo mjedisi nuk janë pjesë e Programit për Reforma Ekonomike. Për qëllime përfaqësimit vizual na është dashur të organizojmë sektorët prioritar në grupet e ndryshme të prioriteteve.

Figura 15: Ndërlidhja e prioriteteve të IPA-së II me prioritetet politike të BE-së



IPA II

Sundimi i ligjit & të drejtat themelore, reforma e drejtësisë, punë të brendshme

Demokracia & qeverisja, institucionet e pavarura dhe demokratike, reforma e administratës publike

Konkurrueshmëria, inovacioni, bujqësia, arsimi, punësimi, politikat sociale, mjedisi, ndryshimet klimatike dhe energjia



FUNDAMENTALS FIRST

Sundimi i ligjit, reforma e drejtësisë, lufta kundër korrupsionit dhe krimit organizuar, siguria, të drejtat themelore

Funksionimi i institucioneve demokratike & reforma e administratës publike

Zhvillimi ekonomik & konkurrueshmëria

Figura 16: Harmonizimi i prioriteteve të IPA-së II me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit (SKZH)



IPA II

Arsimi, punësimi, politikat sociale

Demokracia & qeverisja, sundimi i ligjit & të drejtat themelore

Konkurrueshmëria, inovacioni, bujqësia

Mjedisi, ndryshimet klimatike dhe energjia



SKZH

Kapitali njerëzor, arsimi, punësimi dhe politikat sociale

Qeverisja e mirë, sundimi i ligjit, përshirë reformën e drejtësisë dhe reformën e administratës publike

Industritë konkurruese: NVM, IDH, bujqësia, minerale, privatizimi

Infrastruktura: energjia, rrugë, hekurudha, uji, mbeturinat

Figura 17: Harmonizimi i prioriteteve të IPA-së II me Programin për Reforma Ekonomike (ERP)



IPA II

Arsimi, punësimi, politikat sociale

Demokracia & qeverisja, sundimi i ligjit & të drejtat themelore

Konkurrueshmëria, inovacioni, bujqësia

Mjedisi, ndryshimet klimatike dhe energjia



ERP

Arsimi, punësimi, mbrojtja sociale

Mjedisi i të bërit biznes, reduktimi i ekonomisë joformale: qeverisja, gjyqësori, etj

Ndërmarrësia, bujqësia, inovacioni, industria, ekonomia digjitale, tregtia

Reforma e tregut të energjisë dhe transportit

Duke lëvizur nga vlerësimi i ndërlidhjes së prioriteteve me ndërlidhjen e alokimit financiar përkritazi me prioritetet respektive në kuadër të IPA II dhe buxhetit të Kosovës, kemi vërejtur disa mospërputhje:

- Demokracia dhe qeverisja është prioritet me financim më të lartë në kuadër IPA II, ndërsa në kuadër KASH-it është prioriteti i katërt me financim më të madh;
- Mjedisi është prioritet i dytë me financim më të lartë në kuadër IPA II, ndërsa në kuadër KASH-it nuk është as në mesin e top pesë prioriteteve;
- Nga ana tjetër, rritja ekonomike është prioritet numër një në kuadër KASH-it, ndërsa në kuadër IPA II është prioritet i tretë me financim më të lartë; Shendetësia është prioritet i pestë më i lartë në kuadër KASH-it, ndërsa në kuadër IPA II nuk është prioritet fare.

Figura 18: Krahasimi i pesë prioriteteve me financim më të lartë në kuadër IPA II dhe KASH



Në përfundim, të gjeturat tona sugjerojnë se IPA II është zbatuar në përputhje me prioritetet e procesit integruar të Kosovës dhe prioritetet kyçe zhvillimore nacionale. Kjo është në përputhje me përgjigjet e të anketuarve ku 90.7% pajtohen, apo pajtohen plotësisht, që fondet IPA janë në harmoni me prioritetet e procesit integruar të Kosovës, dhe 72.1% pajtohen, apo pajtohen plotësisht, që fondet IPA janë në përputhje me prioritetet zhvillimore nacionale. Ia vlen të nënvizohet se rishikimi afatmesëm i KE-së për IPA II po ashtu ka konfirmuar që IPA ka përmbushur objektivat e saja në kuptimin e realizimit të prioriteteve të BE-së dhe nevojave të vendeve të zgjerimit.[27]

Sidoqoftë, duhet nëvizuar se kemi vërejtur dallime në alokimet buxhetore për financimin e prioriteteve të njejëta. Në këtë stad kemi të pamundur të konkludojmë nëse këto dallime kanë pasur asyrshtetë e tyre respektive. Sidoqoftë, mund të jetë që përderisa BE vendos një vëmendje më të lartë në fushën e demokracisë dhe qeverisjes së mirë, Qeveria vendos një vëmendje më të lartë në fushën e rritjes ekonomike. Pa marrë parasysh arsyeshtetë mbrapa dallimit në alokimet buxhetore, është me rëndësi që caktimi i prioriteteve dhe ndarjeve financiare të bëhet përmes një dialogu të strukturuar dhe gjithëpërfshirës në mes Qeverisë së Kosovës dhe institucioneve të BE-së.

IPA II ËSHTË E ORIENTUAR KA NDRYSHIMI. Risi kryesore e IPA II ka qenë fillimi për herë të parë të aplikimit të mekanizmit për alokimet bazuar në performansë. Kjo qasje ka filluar të ndryshojë botëkuptimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor pasi që i ka obliguar të mendojnë çdo herë e më shumë për rezultatet dhe impaktin. Në këtë drejtim kemi parë një fokus më të madh në projektet të cilat janë karakterizuar me ndikim dhe qëndrueshmëri më të madhe, siç janë: (1) rehabilitimi i Kosovës B me qëllim përmirësimit të ajrit; (2) financimi i bursës YCS me qëllim të avancimit të administratës publike në Kosovës; (3) Mbështetje Direkte Buxhetore në Reformën e Administratës Publike për të shtyrë përpara ndryshime rrënjësore për një administratë më efektive; (4) Skema e Garantimit të Kredive e cila ka adresuar pengesat kyçe të NVM-ve për qasje në financim. Gjeturat tona mbështeten edhe nga rishikimi afatmesëm i KE-së për IPA II, me ç'rast vlerësimi ka konkluduar se IPA II ka arritur të jetë më strategjike se sa paraardhësi i saj, duke u fokusuar çdo herë e më shumë në reforma kyçe.[28]

MUNGESA E PRONËSISË DHE SINDROMI I "BOTËS PARALELE". Në fushën e integritimit Evropian egziston një përshtypje e fuqishme, por e gabueshme, që çështjet e integritimit Evropian janë përgjegjësi ekskluzive e strukturave qeveritare për

[27] Ibid.

[28] Ibid.

integrim Evropian, respektivisht, Ministrisë së Integritimit Evropian dhe Departamenteve për Koordinim Politikave dhe Integrim Evropian (DIEKP) në ministrinë e linjës. Kjo qasje është bërthama e sindromit të “botës paralele” – ku proceset e integritimit evropian, përfshirë IPA, janë realitetet paralele nën përgjegjësinë e disa burokratëve të cilat komunikojnë me Brukselin dhe vetëm herë pas herë pjesa tjetër e administratës së shtetit përfshihet, me hezitim. Një qasje e këtill krijon mjedis i cili është i karakterizuar me mungesë të pronësisë dhe përkushtimit për proceset e integritimit Evropian. Sa i përket IPA-së, Qeveria ka krijuar strukturat kyçe siç është Koordinatori Kombëtar i IPA-së (NIPAC), Ministria e Integritimit Evropian (MIE), në veçanti Departamenti i Assitencës Zhvillimore (DAZH) dhe çdo ministri ka emëruar Zyrtarë të Lartë Programues (SPO). Po ashtu, një numër i strukturave zyrtare dhe jozyrtare janë krijuar për të avancuar koordinimin e donacioneve. Sidoqoftë, deri më sot këto strukturat kanë pasur një sukses të kufizuar në programimin dhe monitorimin e IPA-së. Një nga arsytet janë levizueshmëria e madhe e stafit, ku për shembull vetëm në vitin e fundit, po thuaj gjysma e stafit të DAZH-it ka lëvizur. Nuk egzistojnë programe sistematike për ngritjen e kapaciteteve. Në këtë drejtim, përgjigjet e të anketuarve konfirmojnë të njëjta gjëjet me ç’rast 46.6% të anketuarve konsiderojnë se trajnimet nuk janë duke u ofruar rregullisht për të siguruar zbatimin e IPA-së. Në një kontekst të këtillë, është Zyra e BE-së ajo që është duke udhëhequr IPA proceset. Kjo u konfirmua edhe nga përgjigjet e të anketuarve me ç’rast shumica e anketuarve konsiderojnë se institucionet nuk janë në udhëheqje të IPA-së, ndërsa 97.7% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që BE-ja është në udhëheqje të IPA-së. Në këtë drejtim, kur në qershor 2019, BE anuloi projektin e menaxhimit të mbeturinave të rrezikshme prej €12 milion, askush nuk u befasua. Disi, këto u konsideruan si paratë e huaja.

KORNIZË E BRISHTË E PLANIFIKIMIT KOMBËTAR. IPA nuk është kopsht magjik. IPA nuk mund të zgjidh të gjitha problemet e Kosovës. Vetëm IPA nuk do mjaftojë për të mbështetur zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe afrimin me BE. Prandaj, IPA duhet të zbatohet në koordinim me politikat nacionale dhe buxhetin e shtetit. Me fjalë të tjera – IPA është e suksesshme, aq sa janë të suksesshme politikat nacionale. IPA nuk mund të shihet si ishull i izoluar, brenda cilit burokratët veprojnë në ç’përputhje me nevojat reale të qytetarëve. Në këtë drejtim, Kosova ka ndërmarr hapat fillestar për të vendosur elementet bazë për një planifikim empirik të politikave qeveritare. Qeveria ka miratuar Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit dhe rregullisht përgatit Programin për Reforma Ekonomike. Po ashtu, Qeveria miraton në baza vjetore planin e punës dhe buxhetin. Sidoqoftë, mungesa e vullnetit serioz politik ka qenë faktor pengues në ndërtimin e një planifikimit të parashikueshëm të politikave qeveritare. Për shembull, Qeveria me një anë zotohet për politikat e

qëndrueshme qeveritare, por në anën tjetër refuzon të ndaj mjete të nevojshme financiare për rehabilitimin e Kosovës B – deri sa KE nuk kërcënon me anulimin e gjithë financimit të BE-së. Ndryshimi i papritur i prioriteteve të qeverisë, siç është rritja e pagave në sektorin publik, apo politizimi i skajshëm i institucioneve të shtetit kanë dëmtuar rëndë besimin në institucionet publike të Kosovës. Për më tutje, Kosova vuan nga mungesa e ndërlidhjes në mes prioriteteve politike dhe alokimeve financiare. Ka një inflacion të dokumenteve strategjike të Qeverisë të cilat kanë krijuar një mjedis të pa qartë të prioriteteve qeveritare. Në fund, duhet nënvizuar që kapacitetet e brishta administrative të institucioneve relativisht të reja të Kosovës, sfidohen në vazhdimësi nga interesat e dyshimtë politik dhe mungesa e vëmendjes serioze politike për zhvillimi ne kapaciteteve institucionale. Një mjedis i këtillë i politik bërjes është më se sfidues për zbatimin efektiv të IPA-së.

MUNGESA E VENDIMMARRJES EMPIRIKE DHE PROCESIVE TË

STRUKTURUARA. Çdo kornizë e suksesshme e planifikimit të politikave qeveritare duhet të jetë e mbështetur në dy shtylla: (1) vendimmarrje empirike, e cila bazohet në politikbërje alternative dhe synimin për arritjen e rezultateve më të prekshme; (2) procedurat e shkruara, gjithëpërfshirëse dhe të strukturuar të cilat ndajnë qartë detyrat dhe përgjegjësitë e secilës palës të interesit. Në këtë drejtim, Kosova ka bërë një progres të kufizuar në ngritjen e strukturave vendimmarrëse për IPA. Vendosja e prioriteteve dhe shqyrtimi i projekteve alternative nuk bëhet në nivelin më të duhur, pasi që ka një përfshirje shumë të kufizuar të vendimmarrësve të nivelit të lartë. Kjo u vë në dukje edhe nga anketuesit, pasi që 41.9% të anketuarve konsiderojnë se prioritetet dhe projektet nuk po miratohen nga niveli më i duhur i vendimmarrjes. Për më tutje, duke se ka një përfshirje shumë të kufizuar të dy pjesëve të rëndësishme të Qeverisë në IPA II: Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Financave. MIE, sëbashku me këto dy struktura, përbënë qendrën e qeverisjes. SIGMA përkufizon qendrën e qeverisjes si: “Arkitektura institucionale në qendër të qeverisë e cila është përgjegjëse për funksionet e planifikimit të politikave dhe koordinimit, duke siguruar kështu funksionimin e mirëfilltë të sistemit qeveritar të politikbërjes.” Në këtë drejtim, ne konsiderojmë se duhet më shumë për tu bërë në krijimin e sinergjive më të mëdha në mes këtyre strukturave të qeverisë në koordinimin e fondeve të BE-së. Instrumentet në dispozicioni, siç është Sistemi i Planifikimit të Integruar (SPI) duhet të luajnë rolin kyç. Duke kthyer vëmendjen nga proceset, ne nuk kemi gjetur dokumentet ligjore të cilat rregullojnë programimin e IPA-së. Proceset e IPA-së nuk zbatohen duke marr për bazë manualet e shkruara dhe transparente të cilat parashohin në detaje procedurat dhe hapat që duhet ndjekur. Programimi më shumë karakterizohet me një qasje individuale dhe ad hoc.

Kjo gjetje është në përputhje me përgjigjet e anektuesvë, me ç'rast 58.2% nuk pajtohen, ose nuk pajtohen plotësisht, se programimi po bëhet mbi një metodologji e cila është e thjeshtë, e qartë, uniforme dhe e shkruar. Për më shumë, 39.5% e anketuesve besojnë se rolet dhe përgjegjësitë e palëve të interesit nuk janë qartë të përkufizuara në kuadër të proceseve të IPA-së. Sa i përket monitorimit dhe raportimit (M&R), përkundër egzistimit të Platformes për Menaxhimin e Huaj (PMN), M&R nuk përdoret rregullisht për të monitoruar zbatimin e IPA-së. Kjo gjetje është në përputhje me përgjigjet e anektuesvë, me ç'rast 39.6% nuk pajtohen, ose nuk pajtohen plotësisht, se të dhënat që burojnë nga monitorimi dhe raportimi i rregullt janë duke u përdorur në kuadër të procesit vendimmarrës apo për të ndërmarr veprime korrigjuese. Si përfundim, mund të konkludojm se fondet e IPA-së duhet të bazohen në procese sistematike të cilat qeverisen nga niveli më i duhur i vendimmarrësëve, gjithnjë duke u bazuar në opcionet empirike, dhe procedurat e shkruara dhe ligjore.

MUNGESA E 'KTHYESHMËRISË AUTOMATIKE' TË FONDEVE. Gjatë zbatimit të IPA-së, ka pasur raste kur Kosova nuk ka arritur të performojë me sukses në zbatimin e reformave kyçe të BE-së. Reforma zgjedhore nuk ndodhi asnjëherë, thirrjet për emërimet bazuar në meritë u injoruan – njëjtë siç u injorua edhe reforma arsimore. Sidoqoftë, Kosova përkundër kësaj ka vazhduar të përfitoj nga paratë e tatimpaguesve të BE-së. Kjo është e padrejtë edhe ndaj qytetarëve të Kosovës, por edhe ndaj tatimpaguesve të BE-së. Siç është bërë thirrje në kuadër të non-paperit të Francës, ne konsiderojmë se do të duhej të egzistonte një “kthyesmeri” automatike e fondeve të BE-së në raste të regresit të vazhdueshëm të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Cfarë do të ndodhë nëse BE-ja deri më 2024 shpenzon 40 milion EURO për arsim, ndërsa Kosova vazhdon të jetë në fundin e rangimit të PISA-së? Prandaj, në këtë kontekst, ne konsiderojmë se IPA duhet të ketë indikatorët specifik sektorial të cilët do të matin progresin e Kosovës. Çdo regres sistematik duhet të adresohet me një mekanizëm automatik të suspendimit dhe/apo zvogëlimit të fondeve të BE-së.

DEFEKTET E ASISTENCËS TEKNIKE. IPA synon të mbështes avancimin e procesit integruar përmes ofrimit të resurseve financiare për zbatimin e reformave. Nga ana tjetër ndryshimi i shoqërisë është një gjë jashtëzakonisht e vështirë. Reformat serioze shkaktajnë rrëximet e qeverive dhe ngritjen e qeverive të reja. Prandaj, ndryshimi dhe reformat janë të rëndësishme, por ato janë vështira. Kërkojnë vullnet të sinqertë politik, kapacitetet e fuqishme administrative dhe mjete të konsiderueshme financiare. Po ashtu, kërkojnë kohë dhe durim. Në këtë drejtim,

mënyra kryesore për të mbështetura zbatimin e reformave publike përmes IPA është asistencë teknike. Dhe logjika është si në vijim: një reformë e caktuar identifikohet. Një ekip i konsulentëve të specializuar dërgohen për të asistuar administratën për një kohë të caktuar – zakonisht 24 muaj, dhe reformat zbatohen.

Besojmë që është vetevidente sa sa e paqendrueshme një logjikë e tillë.

E para, ndryshimi apo reforma, asnjëherë nuk “identifikohen”. Nevoja për ndryshim apo reformë është ose vetevidente për shkak përkushtimit të qartë politik, apo nuk është. Zyrtarët e Komisionit Evropian apo konsulentët nuk mund të “identifikojnë ndryshimin/reformën”. Së dyti, mekanizmi i asistencës teknike është disi natyrshëm i dizajnuar për të stimuluar një sjellje mekanike ndaj reformës publike. Zyrtarët e KE-së janë aty për të ekzekutuar një numër të detyrave specifike, me një qasje mekanike “tick the box”, ndërsa nga ana tjetër kompanitë konsulente ju intereson vetëm profiti që do të kanë nga angazhimet e caktuara. Në këtë drejtim, nuk është për tu habitur se asistencë teknike shpesh kritikohet që është shumë e shtrenjt, pa pronësi nga ana e qeverive dhe me ndikim të kufizuar afatgjatë në zhvillimin e kapaciteteve lokale.[29] Kjo gjetje është në përputhje me përgjigjet e anektuesvë, me ç'rast 65.1% besojnë se IPA do të duhej të financonte më pak asistencë teknike. Në fund, duhet cekur se kohëzgjatja e projekteve të asistencës teknike të IPA-së nuk mundësonë përkrahjen afatgjatë dhe konzistente të reformave. Reformat kërkojnë përkushtimin dhe angazhimin afatgjatë disa vjeçar të ekipeve dhe ekspertëve. Nga ana tjetër, asistencë teknike e IPA-së zakonisht zgjatë 24 muaj dhe është në kontrast me projektet e asistencës teknike të donatorëve bilateral, psh. USAID, Zvicra apo Luksemburgu.

[29] Hulumtim Parlamentar në Efektivitetin e Asistencës, Raporti i Grupit Parlamentar për Borgjin, Asistencën dhe Tregtinë, Mars 2010.

Figura 19: Shtatë mësimet nga IPA II

IPA II ËSHTË SHUMË RELEVANTE

**IPA II ËSHTË E ORIENTUAR DREJT
NDRYSHIMIT**

**MUNGESA E PRONËSISË &
SINDROMI I "BOTËS PARALELE"**

**KORNIZË E BRISHTË E
PLANIFIKIMIT KOMBËTAR**

**MUNGESA E VENDIMMARRJES EMPIRIKE
DHE PROCESEVE TË STRUKTURUARA**

**MUNGESA E 'KTHYESHMËRISË
AUTOMATIKE' TË FONDEVE IPA**

**DEFEKTET E
ASISTENCËS TEKNIKE**

EUROPEAN POLICY INSTITUTE OF KOSOVO 2020

IV. UDHËRRËFYESI PËR IPA III

Komisioni ende nuk ka detajizuar kornizën programuese për IPA III. Kjo do të bëhet pas miratimit të Rregullores për IPA III. Korniza programuese për 2021-2027 do të miratohet nga Komisioni Evropian përmes aktit zbatues dhe do të definoj prioritetet për financim për të përmbushur objektivat e identifikuar.

Prioritetet do të definohet në partneritet me përfituesit, duke marr për bazë agjendën e zgjerimit dhe nevojat e tyre specifike, në harmoni me objektivat e përgjithshme dhe specifike të Rregullores IPA III dhe duke pas parasysh strategjitë nacionale të vendit.

Në këtë drejtim, është me rëndësi që institucionet e Kosovës të përgatiten me kohë për konsultimet me shërbimet e Komisionit Evropian. Në këtë kapitull, do të mbulojmë parimet kryesore të cilat do të duhej të udhëheqin përgatitjet e Kosovës për IPA III.

Duke marr parasysh mësimet nga IPA II dhe risitë nga IPA III, ne kemi identifikuar dhjetë parime të cilat do të duhej të janë themelet e përgatitjeve të Kosovës për IPA III:

- **Pronësia:** Pronësia është element qenësor për suksesin e asistencës zhvillimore. Institucionet e Kosovës duhet të janë në udhëheqje të programimit të zbatimit të IPA-së. Zyrtarët e KE-së dhe kompanitë konsulentë nuk mund të zëvendësojnë administratën shtetërore. Dëshmitë empirike kanë treguar se zhvillimi nuk mund të imponohet nga akterët e jashtëm, prandaj për të siguruar suksesin afatgjatë të asistencës zhvillimore, agjenda zhvillimore duhet të udhëhiqet nga institucionet vendore. Egziston një konsensus gjithnjë në rritje që asistenca e suksesshme zhvillimore duhet të jetë proces i brendshëm nacional, i cili bazohet në strategjitë nacionale të cilat e gëzojnë përkrahjen lokale. Akterët qëllim mirë të jashtëm mund të mbështesin këto përpjekjet, por ata nuk duhet të përpiqen të zëvendësojnë këto kapacitetet vendore. Prandaj, donatorët nuk duhet të synojnë të “blejnë” reformat e caktuara, dhe nese nuk egziston përkrahja dhe pronësia e qytetarëve dhe institucioneve për të krijuar, zbatuar dhe monitoruar politikat e tyre nacionale atëherë gjasat janë që këto reformat nuk do të janë të qëndrueshme dhe efektive. Një nga studimet e fundit të Bankes Botërore ka konkluduar se projektet të cilat kanë gëzuar pronësinë dhe përkrahjen nga ana e

institucioneve lokale, kanë pasur shkallën e suksesit prej 72%, ndërsa 82% e projekteve të cilat kanë pasur përkrahjen e ulët nga institucionet lokale janë identifikuar si të “pa sukseshme”[30].

- **Sundimi i ligjit:** Sundimi i ligjit është epiqendra e politikës së BE-së “fundamentals first” dhe politikës së zgjerimit të BE-së. Në kuadër të non-paperit të fundit për zgjerimin, Franca ka ngritur shqetësimin e të gjitha vendeve anëtare të BE-së kur ka bërë thirrje për fokusim më të madh në çështje të sundimit të ligjit. Propozimi i KE-së për IPA III po ashtu njih rëndësinë e sundimit të ligjit për suksesin e IPA III. Në këtë drejtim, institucionet e Kosovës duhet të arrijnë një konsensus të gjërë politik për të siguruar progres të theksuar në fushën e sundimit të ligjit. Progresi në fushën e sundimit të ligjit do të jetë ngushtë i lidhur me përfitimet nga IPA III.
- **Rritja ekonomike:** Qëllimi i përgjithshëm i IPA-së është të nxitë “reforma ekonomike dhe sociale për të siguruar anëtarësimin në BE.” Prandaj, është shumë e rëndësishme për të mbështetur Kosovën në gjenerimin e rritjes ekonomike e cila është gjithëpërfshirëse dhe e qëndrueshme. Kjo do të duhej të ishte parimi kryesor në kuadër të dizajnit të IPA III. Po ashtu, vëmendje e veçantë duhet të kushtohet llojit të asistencës e cila duhet të përkrah rritjen ekonomike. Në vitin 2009, FMN ka analizuar kontributin e dy llojeve të asistencës për zhvillimin ekonomik: asistencë zhvillimore dhe asistencë jo-zhvillimore[31]. Studimi ka konkluduar se asistencë zhvillimore ka pasur efekt të ndjeshëm dhe pozitiv në rritjen ekonomike, ndërsa asistencë jo-zhvillimore nuk ka pasur efekt në rritjen ekonomike, ose në disa raste ka pasur efekt negativ[32].
- **Planifikimi i integruar strategjik:** Qeveria e Kosovës, me ndihmën e BE-së, ka ngritur Sistemin e Planifikimit të Integruar (IPS) me qëllim të sigurimit të një qasje sistematike, empirike dhe gjithëpërfshirëse në politikbërje nacionale. IPS ka ngritur strukturën gjithëpërfshirëse me qëllimin e vetëm për të bashkuar të gjitha resurset financiare në mbështetje të një agjende të vetme të prioriteteve. Në këtë drejtim, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave dhe Ministria e Integritimit Evropian luajnë rol kyç. Në kuadër të IPA III, Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë se asistencë financiare e IPA-së do subordinohet IPS-it. Kjo do siguroj: (1) fokus më të madh në përkrahjen e reformave kyçe; (2) pronësisë institucionale; (3) rritjes së sinergjisë në mes prioriteteve dhe buxhetit të shtetit; (4) zvogëlimi i barrës administrative dhe harmonizimi më i madh i procedurave qeveritare. Po ashtu, Qeveria duhet të krijoj një listë të unifikuar të projekteve investuese

[30] Ibid.

[31] Asistencë zhvillimore është asistencë e cila pritet të promovoj zhvillimin ekonomik, qoftë përmes rritjes ekonomike apo mënyrave të tjera. Asistencë jo-zhvillimore përkufizohet si asistencë e çdo llojit tjetër.

[32] Asistencë Zhvillimore dhe Rritja Ekonomike: Marrëdhënia Pozitive Afatgjate, FMN, Maj 2019.

(të asistencës teknike dhe infrastrukturës). Kjo do të mund të arrihet duke ndërtuar mbi mësimet e Programit për Investime Infrastrukturore, të përgatitur në kuadër të procesi të Berlinit, si dhe Programit për Investime Publike.

- **Ndikimi dhe vizibiliteti:** IPA duhet të lëviz nga të menduarit bazuar në input, drejt të menduarit bazuar në rezultate. Në këtë drejtim, institucionet e Kosovës duhet të përgatitin intervenimet e IPA III të cilat do të mbështesin projektet të cilat do sigurojnë efekte të prekshme dhe të qëndrueshme afatgjate për qytetarët. Kjo do të reflektonte edhe brengat e Francës se reformat janë duke u zbatuar shumë ngadalë dhe pa përfitime konkrete për qytetarët. Storit e suksesit në IPA II, siç është Pallati i Drejtësisë, TERMOKOS dhe rehabilitimi i Kosovës B duhet të shifin si shembujë më të mirë për intervenimet infrastrukturale në IPA III. Në këtë drejtim, duhet të shqyrtohen mundësitë e bashkimit të fondeve nga buxheti i shtetit me burimet financiare të Institucioneve Ndërkombëtare Financiare, si dhe përfshirja e investimeve private përmes instrumentit të ri financiar – Garantimi Financiar për Veprimin e Jashtëm.
- **Agjentet lokal të ndryshimit:** Administrata e Kosovës nuk është e mirë e pafund publike. Nuk janë as studentët dhe kompanitë e Kosovës. Këto janë resurse deficiare të Kosovës. Prandaj, IPA duhet të gjej mënyra që të njeh potencialin e këtyre agjentëve lokal të ndryshimit dhe në ato raste të gjej mënyra për ti përkahur ato. Këta agjentë lokal të ndryshimit janë në pozitë unike për të siguruar zbatimin e qëndrueshëm të IPA-së, me efekte afatgjatë multiplikuese. Storit e suksesit, sikur Skema e Profesionistëve të Rinj dhe Skema për Garantimin e Kredive duhet të shifin si shembujë më të mirë për të mbështetur “masat e buta” në IPA III. Në veçanti, në IPA III, ne rekomandojmë që YCS të zgjerohet në sektorin privat dhe mbështetje të akademisë.
- **Përdorimi i asistencës teknike për të përkrahur ndryshimin në politikat publike:** Synimi i IPA-së është të mbështes avancimin e vendeve të Ballkanit në rrugën e tyre integruese. Mënyra përmes IPA e bënë këtë është përmes asistencës teknike e cila synon të mbështet zbatimin e politikave të qëndrueshme publike. Sidoqoftë, asistenca teknike vuan nga një “mëkat fillestar” – me ç’rast profiti është interesimi kryesor i kompanive të cilat zbatojnë asistencën teknike. Një situatë e tillë vendos barrën e shtyerjes reformave jo mbi kompanitë, por mbi kapacitetet e limituara të institucioneve lokale. Prandaj, asistenca teknike duhet të përdoret vetëm në raste ku ka një potencial të qartë për ndryshim. Në fund, IPA III duhet të njeh se ndryshimi është proces afatgjatë i cili kërkon përkushtimin e vazhdueshëm të ekipeve teknike përgjatë disa viteve. Rrjedhimisht, ndryshimi i politikave publike nuk mund të mbështetet me projekte të asistencës teknike të cilat zgjasin 24 muaj. Projekte të tilla përfundojnë duke qenë më shumë pengesë në administratën publike, se sa ndihmesë. Në këto raste, ndryshimi nuk ndodh për shkak këtyre projekteve, por përkundër tyre.

- **Kapacitetet efektive institucionale:** IPA III është instrument kompleks i cili kërkon kapacitete të konsoliduara institucionale. Kërkon vullnet politik dhe kapacitete teknike për të ndërmarr reforma Evropiane. Në këtë drejtim, institucionet e Kosovës duhet të njohin rëndësinë e të pasurit një administratë të kualifikuar dhe kompetente e cila është në gjendje të menaxhoj procese të integritimit Evropian. Rekrutimet dhe emërimet në kuadër të administratës duhet të bëjnë mbi bazën e meritës dhe vetëm meritës. Kjo është në veçanti me rëndësi duke njohur faktin se IPA III do të ndahet mbi bazën e kualitetit të projekteve që do të përgatiten nga vendet e Ballkanit. Institucionet e Kosovës duhet të tërhekin stafin më të kualifikuar të mundshëm për të qenë në gjendje të janë konkurrent me administratat e vendeve të Ballkanit të cilat kanë një përvojë dhe histori administrative shumë më të gjatë.
- **Procedurat sistematike të IPA-së:** Kosova duhet të ngrit kuadrin ligjor i cili do të jetë bazë e programimit, zbatimit dhe monitorimit të IPA-së. Një kuadër i tillë do sigurojë se IPA III do të jetë e bazuar mbi manualët dhe udhëzuesit e shkruar dhe transparent për të gjithë punonjësit e administratës. Kjo do ndryshonte zbatimin e IPA-së nga një zbatim i bazuar mbi një qasje ad hoc dhe individuale në një qasje të strukturuar dhe orientuar ka rezultatet. Procedurat e programimit për IPA III duhet të sigurojnë dy gjëra: (1) eksperet duhet të kanë hapësirën e nevojshme për të formuluar prioritetet dhe projektet; ndërsa (2) trupa më e lartë e vendimmarrjes duhet të jetë e përfshirë në rishikimi dhe përcaktimin e prioriteteve. Në fund, institucionet duhet të ngritin një sistem të besueshëm të monitorimit dhe raportimit. Sistemi duhet të ofroj të dhëna të qarta dhe të kuptueshme për progresin dhe sfidat në zbatimin e IPA-së.
- **Partneriteti dhe llogaridhënia:** IPA III nuk mbështet ndonjë Qeveri në veçanti. Ajo mbështet Kosovën. Në këtë drejtim, institucionet duhet të sigurojnë një proces transparent dhe gjithëpërfshirës në zbatimin e fondeve të IPA-së. Kjo në veçanti nënkupton përfshirjen substanciale të donatorëve, Institucioneve Ndërkombëtare Financiare, shoqërinë civile, komunitetin e biznesit dhe palët e tjera të interesit. Mediatë duhet të mbahen të informuara nga afër për IPA me qëllim të sigurimit të transparencës dhe vetëdijesimit për rezultatet e IPA-së. Po ashtu, Qeveria duhet të raportoj rregullisht pranë Kuvendit për përdorimin e fondeve të BE-së. Kjo do të siguroj pronësi dhe ndarje të përgjegjësive në mes gjithë spektrit politik.

Figura 20: Dhjetë parime për përgatitjet për IPA III





Figura 21: Nga mësimet e IPA II në parimet e IPA III



Në kuptimin e procesit këto janë 10 hapa që ne propozojmë.

Figura 22: Dhjetë hapa për zbatimin e IPA III



V. PRIORITETET KYÇE PËR IPA III

Duke marr për bazë dokumentet kyçe që përbëjnë kornizën nacionale të planifikimit, respektivisht:

- Marrëveshja Stabilizim Asocimi në mes Kosovës dhe BE-së;
- Strategjinë Zhvillimore të Nacionale;
- Programin për Reforma Ekonomike;
- Planin Shumëvjeçar për Hapësiren Rajonale Ekonomike (MAP);

ne propozojmë trembdhjetë prioritetet të grupuara në katër fusha prioritare.

Sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore: Sundimi i ligjit është themel i politikës së zgjerimit të BE-së. Ai përbënë elementin kyç të politikës “fundamentals first”. Rrjedhimisht, sundimi i ligjit është edhe faktori kryesor i cili determinon liberalizimin e vizave dhe progresin drejt statusit të vendit kandidat. Njëkohësisht, sundimi i ligjit njihet si një nga pengesat kryesore për rritjen ekonomike në kuadër të Programit për Reforma Ekonomike. Krahas sundimit të ligjit, një nga çështjet që duhet të këtë vëmendjen e veçantë në kuadër IPA III është migrimi, pasi që paraqet një nga brengat kryesore të vendeve anëtare.

Demokracia & qeverisja: IPA nuk është vetëm një fond financiar. IPA është hapi i parë drejt marrjes së përgjegjësive për të qenë vend anëtare i BE-së. Qëllimi i IPA-së është fuqizimi i kapaciteteve administrative dhe institucionale me qëllim të përafrimit me institucionet e BE-së. Paralelisht me fuqizimin e institucioneve, vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet përkrahjes së akterëve të jashtëm social, siç janë institucionet e pavarura, media dhe shoqëria civile.

Zhvillimi ekonomik: Siç është nëvizuar nga diskutimet më të fundit për të ardhmen e zgjerimit të BE-së, rezultatet e zgjerimit duhet të janë më të prekshme. Prandaj. Theks i veçantë duhet të vendoset në ngritjen e konkurrueshmërisë së Kosovës dhe gjenerimin e vendeve të punës për qytetarët. Kjo do ofroj perspektivë për qytetarët dhe do ndaloj migrimin e tyre në BE. Rrjedhimisht, siç është nëvizuar edhe në kuadër SKZH-së, IPA duhet të përkrah zhvillimin e kapitalit njerëzor. Prandaj, është shumë e rëndësishme që IPA të mbështet reformat në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë. Komisioni Evropian në vazhdimësi ka refuzuar të përfshihet në sektorin e shëndetësisë, pasi që kjo çështje nuk është kompetencë e BE-së, KE duhet të shyrtoj mundësitë inovative për të përkrahur këtë sektor.

Agjenda e Gjerlbër e Kosovës: BE-ja synon të jetë deri në vitin 2050 kontinenti i parë në botë i cili nuk do të shkaktoj emetimet negative klimatike. Për të arritur këtë, BE-ja ka miratuar Agjendën e e Gjelbër Evropiane – një paketë ambicioze të masave të cilat do të mbështesin tranzicionin e qytetarëve dhe bizneseve drejt tranzicionit të qëndrueshëm mjedisor. Nën IPA III, qëllimi i Komisionit është të alokoj 16% të buxhetit të IPA-së në mbështetje të masave kundër ndryshimeve klimatike. Liderët e Ballkanit Perëndimor në dhjetor 2019 në Tiranë, janë zotuar të mbështesin Agjendën e Gjelbër Evropiane. Në këtë drejtim, IPA III duhet të mbështet intervencimet të cilat do të promovojnë politikat e qëndrueshme mjedisore të cilat do të ofrojnë mundësitë e reja ekonomike.

Është vetevidente se një kornizë e këtillë e përgjithshme e prioritetëve kërkon detajizim të më tutjeshëm, sidoqoftë ne besojmë se kjo është pikënisja e duhur për të filluar një diskutim strategjik për orientimin e IPA III dhe rëndësinë e secilës fushë prioritate në IPA III.

Figura 23: Prioritetet kyçe për IPA III



VI. REKOMANDIMET

Për risitë e IPA III:

1. Më strategjik;
2. Më e fokusuar;
3. Më shumë investime;
4. Më shumë ndikim.

Për mësimet nga IPA II:

1. IPA II është shumë relevante;
2. IPA II është e orientuar drejt ndryshimit;
3. Ekziston mungesa e pronësisë dhe sindromit të "botës paralele";
4. Kornizë e planifikimit kombëtar është e brishtë;
5. Mungesa e vendimmarrjes empirike dhe proceseve të strukturuar;
6. Mungesa e 'kthyeshmërisë automatike' të fondeve IPA;
7. Defektet e asistencës teknike.

Për parimet kyçe të cilat duhet të janë bazat e përgatitjeve për IPA III:

1. Pronësia;
2. Sundimi i ligjit;
3. Rritja ekonomike;
4. Planifikimi i integruar strategjik;
5. Ndikimi dhe vizibiliteti;
6. Agjentet lokal të ndryshimit
7. Përdorimi i asistencës teknike për të përkrahur ndryshimin në politikat publike;
8. Kapacitetet efektive institucionale;
9. Procedurat sistematike të IPA-së;
10. Partneriteti dhe llogaridhënia.

Për **hapat e ardhshëm** drejt zbatimit të IPA III:

1. Qeveria mandaton Komitetin për Planifikim Strategjik për të përgatitur qëndrimin e Kosovës për IPA III;
2. Drafti i parë i qëndrimit të Kosovës për IPA III diskutohet dhe miratohet në Qeveri;
3. Qeveria prezanton qëndrimin e Kosovës për IPAIII Komisionit për Integrim Evropian në Kuvendin e Kosovës;
4. Qeveria prezanton qëndrimin e Kosovës për IPA III palëve të jashtme;
5. Qëndrimi i Kosovës për IPA III miratohet në Qeveri;
6. Qëndrimi i Kosovës për IPA III prezantohet në Kuvend;
7. Dialogu në mes Qeverise dhe Komisionit Evropian për prioritetet dhe projektet e IPA III;
8. IPA III 2021-2027 prioritetet dhe projektet miratohen;
9. IPA III programimi për periudhën 2021-2027 diskutohet rregullisht në Komitetin për Planifikim Strategjik dhe Qeveri;
10. Qeveria rregullisht informon Kuvendin për zbatimin e IPA III.

Për **prioritetet kyçe** për IPA III:

1. Sundimi i Ligjit & të Drejtat Themelore
 - a. Drejtësia dhe Siguria
 - b. Migrimi
 - c. Të drejtat e njeriut

2. Demokracia & Qeverisja
 - a. Administrata publike
 - b. Të drejtat themelore
 - c. Shoqëria civile

3. Rritja ekonomike
 - a. Ndërmarrësia
 - b. Arsimi
 - c. Agjenda digjitale
 - d. Shëndetësia & mbrojtja sociale

4. Agjenda e Gjelbër e Kosovës
 - a. Mjedisi
 - b. Transporti & energjia
 - c. Bujqësia & siguria e ushqimit

LISTA E FIGURAVE

- Figura 1: Karakteristika kyçe të buxhetit të ardhshëm të BE-së
- Figura 2: Buxheti i BE-së krahasuar me të hyrat e BE-së dhe shpenzimet publike
- Figura 3: Madhësia e buxhetit të BE-së si përqindje e BHV-së
- Figura 4: Evoluimi i fushave prioritare brenda buxhetit të BE-së
- Figura 5: Struktura e MFF-së 2021-2027 (në miliard euro, çmimet aktuale)
- Figura 6: Fushat me rritjen më të madhe të financimit
- Figura 7: Zvogëlimi i numrit të instrumenteve me MFF 2021-2027
- Figura 8: Buxheti i IPA II vs IPA III
- Figura 9: Buxheti IPA, sipas viteve
- Figura 10: Objektivat e IPA-së III
- Figura 11: Indikatorët e IPA III, sipas pesë objektivave specifike
- Figura 12: Risitë e IPA III
- Figura 13: Evoluimi i elementeve kryesore të IPA-së çysh nga 2007
- Figura 14: Alokimet financiare në miliona EURO
- Figura 15: Ndërlidhja e prioriteteve të IPA-së II me prioritetet politike të BE-së
- Figura 16: Ndërlidhja e prioriteteve të IPA-së II me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit (SKZh)
- Figura 17: Ndërlidhja e prioriteteve të IPA-së II me Programin për Reforma Ekonomike (ERP)
- Figura 18: Krahasimi i pesë prioriteteve me financim më të lartë në kuadër IPA II dhe KASH
- Figura 19: Shtatë mësimet nga IPA II
- Figura 20: Dhjetë parime për përgatitjet për IPA III
- Figura 21: Nge mësimet e IPA II në parimet e IPA III
- Figura 22: Dhjetë hapa për zbatimin e IPA III
- Figura 23: Prioritetet kyçe për IPA III

REFERENCAT

1. Reflektimet për të ardhmen e financave të BE-së, KE, qershor 2017;
2. Buxhet modern për Unionin i cili Ruan, Fuqizon dhe Mbron, KE, maj 2018;
3. Kontributi i Komisionit Evropian për takimin e Këshillit Evropian me 17-18 tetor 2019, KE, tetor 2019;
4. Buxheti modern për sfidat e reja, KE, tetor 2019;
5. Instrumenti i ri i Asistencës së Para-Anëtarësimit, KE, qershor 2018;
6. Propozimi për Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për themelimin e Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA III), KE, qershor 2018;
7. Migrimi i Ballkanit Perëndimor drejt BE-së, Instituti i Kosovës për Politikën Evropiane, nëntor 2019;
8. Të rinjtë në Shqipëri 2019, Rrjeti Kombëtar i të Rinjve të Shqipërisë, nëntor 2019;
9. Sfidat dhe perspektivat e Rinisë në Kosovë, UNDP Kosova, gusht 2018;
10. Hulumtim Parlamentar në Efektivitetin e Asistencës, Raporti i Grupit Parlamentar për Borgjin, Asistencën dhe Tregtinë, Mars 2010;
11. Asistenca Zhvillimore dhe Rritja Ekonomike: Marrëdhënia Pozitive Afatgjate, FMN, Maj 2019.

SHTOJCA: ZËRAT E IPA-SË

Me qëllim të reflektimit të qëndrimeve të palëve të ndryshme përkitazi me programimin, monitorimin dhe zbatimin e IPA-së kemi realizuar një pyetësor të standardizuar.

Pyetësori ka qenë i bazuar në 47 pyetje, të strukturuar në 8 fusha.

- 1.Relevanca;
- 2.Koherenca & Sinergjia;
- 3.Efektiviteti;
- 4.Efikasiteti;
- 5.Pronësia;
- 6.Fleksibiliteti;
- 7.Programimi & monitorimi;
- 8.Prioritetet për IPA III.


Pyetësori ka qenë i ndarë me një grup të anketuarve prej institucioneve shtetërore, KE, shoqëria civile dhe komuniteti i donatorëve. Rezultatet e pyetësorit bazohen në përgjigje prej 43 respondentëve.

Sa i përket **relevances**, egziston një konsensus i ndjeshëm në mesin e anketuarve se IPA është duke mbështetur prioritetet e duhura të integritit Evropian, si dhe prioritetet e duhura nacionale. Po ashtu, ajo është në harmoni me asistencën e donatorëve.

- 90.7% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që IPA fondet janë në harmoni me prioritetet e integritit Evropian.

IPA funds are in line with EU integration priorities?


43 responses



- 72.1% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që IPA fondet janë në harmoni me prioritetet zhvillimore të Kosovës.

IPA funds are in line with Kosovo national development priorities?


43 responses



- 76.7% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që IPA fondet janë në harmoni me asistencën e donatorëve.

IPA funds are in line with donor assistance?

43 responses




Sa i përket **koherencës & sinergjisë**, përderisa ka konsensus të gjërë se IPA është e fokusuar, shumica e anketuarve konsiderojnë procesi i konsultimeve të IPA-së nuk është efektiv.

- 81.4% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që IPA është e fokusuar, dhe mbulon prioritetet specifike.

IPA is very focused, covering specific areas and priorities?


43 responses



- 58.2% nuk pajtohen, ose nuk pajtohen plotësisht, që procesi i konsultimeve për IPA është efektiv dhe eficient.

IPA consultation process is effective and efficient?


43 responses



- 51.2% nuk pajtohen, ose nuk pajtohen plotësisht, që idejet e tyre ndikojnë në IPA.

My opinion shapes IPA?


43 responses



Sa i përket **efektivitetit**, përderisa ka konsensus në mesin e anketuarve se IPA kontribuon në procesin integruar dhe menaxhohet më mirë se donacione të tjera, ka një dallim të konsiderueshëm në mendimet e anketuarve nese IPA është e fokusuar në rezultatet/impaktin dhe nese është duke financuar projekte më të mira. Po ashtu, shumica e anketuarve nuk konsiderojnë se Kosova është storie e suksesit në menaxhimin fondeve të BE-së, dhe është më pak e suksesshme se vendet e rajonit në absorbimin e fondeve të BE-së.


- 76.8% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që IPA kontribuon në avancimin e procesit integrues.

IPA makes a significant contribution to the EU integration process?
43 responses




- 46.58% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që IPA është e fokusuar në rezultate/impaktin, se sa procese. 44.2% nuk pajtohen, ose nuk pajtohen plotësisht.

IPA is more focused on impact and results, rather than processes?
43 responses



- 51.2% nuk pajtohen, ose nuk pajtohen plotësisht, që IPA fuqizon agjentet lokal.


IPA empowers local agents?
43 responses



- 44.2% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që IPA financon projekte më të mira. 39.5% nuk pajtohen, ose nuk pajtohen plotësisht.

IPA funds best projects?


43 responses



- 46.6% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, that IPA menaxhohet më mirë se donacione të tjera.

IPA is managed better than other donor funds?


43 responses



- 51.2% nuk pajtohen, ose nuk pajtohen plotësisht, që Kosova performon më mirë se vende të tjera të rajonit në absorbimin e fondeve të BE-së.

Kosovo performs better than the region in absorption of IPA funds?


43 responses



- 51.2% nuk pajtohen, ose nuk pajtohen plotësisht, që Kosova është storie e suksesit në absorbimin e fondeve të BE-së.

Kosovo is a success story in absorbing EU funds?


43 responses



- 51.2% nuk pajtohen, ose nuk pajtohen plotësisht, që mësimet në vazhdimësi janë duke u marr parasysh ne zbatimin e IPA-se.

Lessons learned are always taken into account?

43 responses




Sa i përket efijencies, shumica e anketuarve konsiderojnë se IPA nuk është financiarisht efektive. Do të duhej të financonte më pak asistencë teknike, dhe në vend të kësaj më shumë bursa për arsim, grante, mbështetje direkte buxhetore dhe infrastrukturë.

- 48.9% nuk pajtohen, ose nuk pajtohen plotësisht, që IPA është financiarisht efektive.

IPA is very cost-effective?


43 responses



- 62.8% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që IPA duhet të financoj më shumë infrastrukturë.

IPA should fund more infrastructure?


43 responses



- 65.1% nuk pajtohen, ose nuk pajtohen plotësisht, që IPA duhet të financoj më shumë asistencë teknike.

IPA should fund more technical assistance?


43 responses



- 79.1% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që IPA duhet të financoj më shumë grante.

IPA should fund more grants?


43 responses



- 88.4% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që IPA duhet të financoj më shumë bursa për arsim.

IPA should fund more education scholarships?


43 responses



- 76.7% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që IPA duhet të financoj më shumë instrumente të mbështetjes direkte buxhetore.

IPA should fund more budget support instruments?

43 responses




Sa i përket **pronësisë**, shumica e anketuarve konsiderojnë se institucionet nuk janë në procesi të IPA-së, dhe në vend të kësaj pronësia është në duar të KE-së. Po ashtu, ata konsiderojnë se donatorët dhe shoqëria civile nuk janë të përfshirë substancialisht në proceset e IPA-së.

- 51.2% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që MIE është në udhëheqje të IPA-së. 48.8% nuk pajtohen, ose nuk pajtohen plotësisht.

MEI is in the lead of IPA?


43 responses



- 72.1% nuk pajtohen, ose nuk pajtohen plotësisht, që ministrinë e linjës janë në udhëheqje të IPA-së.

Line ministries are in the lead of IPA?


43 responses



- 97.7% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që BE është në udhëheqje të IPA-së.

EU is in the lead of IPA?


43 responses



- 48.8% nuk pajtohen, ose nuk pajtohen plotësisht, që donatorët janë sistematikisht dhe substancialisht të përfshirë në programimin dhe zbatimin e IPA-së.

Donors are systematicaly and substantively involved in IPA prograaming and implementation?


43 responses



- 53.5% nuk pajtohen, ose nuk pajtohen plotësisht, që shoqëria civile është e përfshirë sistematikisht dhe substancialisht të përfshirë në programimin dhe zbatimin e IPA-së.

Civil society view is systematicaly and substantively involved in IPA prograaming and implementation?

43 responses




Sa i përket **fleksibilitetit**, shumica e anketuarve konsiderojnë se IPA është jo fleksibile dhe e komplikuar.

- 67.4% nuk pajtohen, ose nuk pajtohen plotësisht, që IPA është fleksibile.

IPA is sufficiently flexible?


43 responses



- 72.1% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që IPA është e lehtë për menaxhim.

IPA is administratively burdensome?

43 responses




Sa i përket **programimit & monitorimit**, shumica e korrespondentëve konsiderojnë se IPA zbatohet në përputhje me dokumentet ligjore. Sidoqoftë, opinioni është i ndarë nese IPA zbatohet mbi një procedurë të shkruar dhe uniforme – me ndarje të qartë të përgjegjësi të akterëve të ndryshëm. Anketuesit kanë qëndrime të kundërta sa i përket ekzistencës së strukturave vendimmarrëse. Po ashtu, mendimet janë të ndara në një numër çështjeve siç janë: përfshirja e palëve të jashtme, ndarja e detyrave dhe përgjegjësi, monitorimi dhe raportimi, etj.

- 51.2% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që programimi bëhet mbi një metodologji të thjeshtë, uniforme dhe të shkruar. 41.9% nuk pajtohen, ose nuk pajtohen plotësisht.

Programing is done on the basis of simple, clearly defined, uniform, regular and written methodology, rather than ad hoc processes?


43 responses



- 65.1% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që programimi & monitorimi bëhet duke marr për bazë dokumentet ligjore dhe udhëzuesit praktik.

Programing & monitoring is based upon legal and policy documents, as well as practical guidelines?


43 responses



- 46.6% nuk pajtohen, ose nuk pajtohen plotësisht, që trajnimi ofrohet rregullisht për të siguruar zbatimin e metodologjisë për programim & monitorim. 37.2% pajtohen, ose pajtohen plotësisht.

Training is regularly offered to ensure proper implementation of the programing & monitoring methodology?


43 responses



- 53.5% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që programimi & monitorimi bazohet mbi qasje institucionale, se sa qasje individuale dhe ad hoc.

Programing & monitoring is based upon institutional approach, rather than persons and individuals?


43 responses



- 44.2% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që prioritetet dhe projektet vendosen nga niveli më i duhur vendimmarrës. 41.9% nuk pajtohen, ose nuk pajtohen plotësisht.

Priorities and projects are decided by the most appropriate decision-making body?


43 responses



- 44.2% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që ekspertet kanë rolin e duhur në programim & monitorim. 30.2% nuk pajtohen, ose nuk pajtohen plotësisht.

Experts have a sufficient say in the programming & monitoring process?


43 responses



- 46.5% pajtohen që palet e interesit përfshihen në menyrë transparente, me kohë dhe substancialisht. 44.2% nuk pajtohen, ose nuk pajtohen plotësisht.

Stakeholders are timely and substantively involved and their feedback is part of the transparent process?


43 responses



- 51.1% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që detyrat dhe përgjegjësitë e çdo pale të interesit janë të qarta. 39.5% nuk pajtohen.

Roles and responsibilities of each stakeholder are clearly defined?


43 responses



- 74.5% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që afatet komunikohen me kohë.

Deadlines are timely communicated?


43 responses



- 53.5% nuk pajtohen, ose nuk pajtohen plotësisht, që mësimet analizohen dhe aplikohen në kuadër proceseve të IPA-së. 39.6% pajtohen.

Lessons learned are analyses and applied?


43 responses



- 51.2% pajtohen që monitorimi është kuantitativ dhe kualitativ. 39.5% nuk pajtohen, ose nuk pajtohen plotësisht.

Monitoring is both quantitative and qualitative?


43 responses



- 41.8% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që monitorimi është pjesë e procesit vendimmarrës dhe përdoret për veprime korrektuese. 39.6% nuk pajtohen, ose nuk pajtohen plotësisht.

Monitoring feeds into decision-making process and used for corrective actions?

43 responses




Sa i përket **prioriteteve për IPA III**, anketuesit konsiderojnë se arsimi, mjedisi, konkurrueshmëria, sundimi i ligjit dhe shëndeti janë top pesë prioritetet. Duke njohur faktin që KE nuk ka financuar sektorin shëndetësor nën IPA II, kjo çështje duhet të analizohet më detajisht.

- 93.1% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që arsimi duhet të jetë prioritet kyç në IPA III.

I believe education should be key priority in IPA III?


43 responses



- 86% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që konkurrueshmëria duhet të jetë prioritet kyç në IPA III.

I believe competitiveness should be key priority in IPA III?


43 responses



- 83.7% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që sundimi i ligjit duhet të jetë prioritet kyç në IPA III.

I believe rule of law should be key priority in IPA III?


43 responses



- 81.4% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që shëndetësia duhet të jetë prioritet kyç në IPA III.

I believe health should be key priority in IPA III?


43 responses



- 76.8% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që reforma e administratës publike duhet të jetë prioritet kyç në IPA III. 20.9% nuk pajtohen, ose nuk pajtohen plotësisht.

I believe public administration reform should be key priority in IPA III?


43 responses



- 69.7% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që bujqësia duhet të jetë prioritet kyç në IPA III. 27.9% nuk pajtohen, ose nuk pajtohen plotësisht.

I believe agriculture should be key priority in IPA III?


43 responses



- 58.1% pajtohen, ose pajtohen plotësisht, që shoqëria civile dhe mediat duhet të jenë prioritet kyç në IPA III. 37.2% nuk pajtohen, ose nuk pajtohen plotësisht.

I believe civil society and media should be key priority in IPA III?

43 responses



(faqe qëllimisht lënë zbrazët)

